



P.nr.14/2014

## NE EMER TE POPULLIT

Gjykata Themelore në Gjilan, Departamenti i pergjithshem- dega në Novobërdë, përmes gjyqtarit të vetëm Hasan Sadiku, me proqesmbajtsën Mimoza Mehmeti, në qështjen penale kundër të akuzuarve I C nga Prishtina, dhe A J nga fsh. , Komuna e Poçujevës, për shkak të veprës penale vjedhje e e rëndë nga neni 253 parag. 1 pika 1 lidhur me nenin 23 të KPK-së, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar me dat. 05.09.2016 mori dhe publikisht komunikoi këtë,

### A K T G J Y K I M

I akuzuari A J , pa pseudonim dhe emër të rrejshëm, nga i ati R , dhe e ëma H , e lindur, R , i lindur , në fshatin , KK, Podujevë, tani me vendbanim të përkohshëm në Finland, i martuar baba i tre fëmijve, ka të kryer shkollën e mesme i punësuar, në Finlandë, i gjendjes se mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës se Kosoves, kinse me pare i pa gjykuar dhe nuk zhvillohet procedur tjetër penale ndaj tij.

### Eshtë fajtor

Me qëllim që me përvetsimin e sendeve të luajtshme që vedit ti sjellë përfitim pasuror të kundërligjshëm, pas marveshjes paraprake për të vjedhur në bashkëveprim me të pandehurit e mitur , me datë 04.10.2006 rreth orës 06.00, të mëngjezit në fsh. Komuna e Novobërdës, në linjën e teleferikut i cili bartë xehen e Artanës, me përdorimin e forcës dhe me mjete të përshtatshme autogen si dhe me makin prerse të metalit kanë prerë shtyllën e teleferikut në gjatësi të ndryshme dhe i kan ngarkuar në kamionin e tipit "Ford" me ngjyrë të kuqe, me targa te regjistrimit pronë e të akuzuarit I C , me që raste të dëmtuarës Minjerës së Artanës, i kan shkaktuar dëm në vlerë prej 1260 euro.

-me qka në bashkveprim kanë kryer veprën penale Vjedhje e rëndë, nga neni 253 paragrafi 1 pika 1 lidhur me nenin 23 te KPK-se.

Andaj gjykata në bazë të nenit 3, 23, 34, 41, 42,43, 64, të KPK-ës, si dhe nenit 391 të KPRK-së,

## E GJYKON

Me dënim burgu secilin në kohëzgjatje prej nga 6 (gjashtë) muajve, të cilin dënim të akuzuari nuk do ta mbajnë, ne qofte se në afat prej 1 (një) vite ,nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nuk kryen ndonje vepër tjetër penale.

I akuzuari obligohet që në emër të paushallit gjyqësor të paguajnë shumën prej nga 20 €, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotëfuqishmërisë së aktgjykimit ,nën kërcënim të përmbarrimit të dhunshëm.

E dëmtuara Minjera "Artana", për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontestin civil.

### A r s y e t i m

Prokuroria Komunale në Gjilan, me aktakuzën PP.nr.3391-10/2006 dhe PPM.nr. 355-7/2006 të dates 27.10.2006, i ka akuzuar I C , nga Prishtina dhe A J nga fsh. Komuna e Podujevës, për shkak te vepres penale Vjedhje e rend , nga neni 258 paragrafi 1 pika 1 lidhur me nenin 23 te KPK-se.

Prokurorja e shtetit Kujtesa Fazliu, ne seancën fillestare ka deklaruar: se mbetem pranë aktakuzës së ushtruar me shkrim, dhe i propozoi gjykatës që të akuzuarin ta shpalli fajtor dhe të i shqiptohet denimi meritor sipas kodit penal, gjithnje duke i marrë per bazë lehtësuese dhe ato rënduese.

I akuzuari A - J , ne shqyrtimin fillestar ka deklaruar se e pranojme fajësinë për veprën penale si në aktakuzë, shprehim keqardhje dhe pendohemi dhe se i premtojmë gjykatës se në të ardhmen kurrë nuk do të biem ndesh me ligjin, se këtë pranim e bëjmë në mënyrë vullnetare edhe se jamë njoftuar për pasojat dhe benefitet e pranimit te fajësisë.

Megjense i akuzuari ne seancën fillestare sipas kësaj qështje penale e ka pranuar fajësinë për të gjitha pikat e aktakuzës e me këtë sipas vlerësimit të kësaj gjykate, gjendja faktike nuk është kontestuese , sepse perpos pranimit të fajësisë nga ana e të akuzuarit një pranim i tillë ka edhe mbeshtetje në provat e grumbulluara te cilat gjenden ne shkresat e lendes dhe se i akuzuari vullnetarisht e ka pranuar fajësinë, se e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje ligjore, andaj gjykata e vazhdoj procesin ndaj të njëjtit me shqiptimin e dënimit pa shkuar fare në shqyrtim gjyqësor kështu duke vepruar në pajtim me dispozitën e nenit 248 paragrafi 4 te KPPK-se, dhe pa fjalë përfundimtare.

Me rastin e përcaktimit për llojin dhe lartësinë e dënimit për të akuzuarit gjykata i ka marrë parasyshtë të gjitha rrethanat të cilat kanë ndikim që dënimi të

jetë më i butë apo më i rendë, ashtu siq e parasheh edhe dispozita e nenit 73 dhe 75 të KPRK-së. Keshtu si rrethanë lehtësuese për të akuzuarit gjykata pati parasysh pranimin e fajësisë qka do të thotë se të akuzuarit kanë pranuar të jenë bashkepunues, është penduar për veprën penale, si dhe premtimin se në të ardhmen nuk do të bien ndesh me ligjin, si dhe gjendjen e varfër ekonomike. Ndërsa si rrethanë rënduese për të akuzuarin gjykata pati parasysh shkallën e përgjegjësisë penale, rrezikshmërin shoqërore dashjen për kryerjen e vepër penale dhe pasojen e shkaktuar nga kjo vepër penale.

Me dënimin e shqiptuar ndaj të akuzuarit, gjykata vlerëson se do të arrihet qëllimi i dënimit ashtu që të akuzuarin do ti parandalojë që në të ardhmen të mos kryejnë vepra tjera penale dhe do të ndikojë edhe tek qytetarët tjerë që të përmbahen nga kryerja e veprave penale.

Për shpenzimet e procedurës gjykata ka vendosur në kuptim të nenit 102 parag. 1, të KPPK-së.

Gjykata konform nenit 108 të KPK-së, të dëmtuarin, për realizimin e kërkesës pasuror-juridik, udhëzohet në kontest civil.

Nga të cekurat më lartë gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata Themelore në Gjiilan, Dega në Novobërdë - Departamenti i përgjithshëm

P.nr. 14/2014, më 05.09.2016

Proqesmbajtsja,  
Mimoza Mehmeti,



**Këshilla Juridike:** Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankësë në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, për mes kësaj gjykate.

